



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Abi Company shpk” të datës 21.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës “Qamil Batalli” me nr. të prokurimit 616-25-4319-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Abi Company shpk” të datës 21.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës “Qamil Batalli” me nr. të prokurimit 616-25-4319-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Abi Company shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 21.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës “Qamil Batalli” me nr. të prokurimit 616-25-4319-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës. Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimet ankimore: "Pika ankimore nr 1: Ke kerkesen 1 pika 3 eshte kerkuar si deshmi; Nje vertetim nga Gjykata qe verteton se a. Operatori Ekonomik, ndonje drejtues, menaxher ose drejtor I saj gjate dhjete viteteve te kaluara nuk eshte shpalle fajtores nga nje Gjykate Kompetente per kryerjes e nje vepre Penale. Sipas qasjeve ne dokumenteve te GR OE te njejtin nuk kan dorezuar VERTETIM nga Gjykata per pronaret e kompanise te Art-Eda shpk si Lider por as per anetarin e Konserciumit H&S Partners group shpk. Ju si AK-se ne kundershtrim me LPP keni shperblyer me kete aktivitet te prokurimit GR OE fitues ofruar deshmi Vertetimet nga Gjykata per pronaret e kompanise. Ku ne dosje tenderit pershkruhet qarte se mos dorezimi I ketyre dokumenteve ateherë AK dote refuzoje tenderin dhe dote ndermarrje masa ligjore sipas nenit 99.2 LPP-se Pika ankimore nr 2: Sipas Certifikates se regjistrimit ne ARBK konstatohet se Besim Mulaj eshte pronar I kompanise. Z Mulaj eshte drejtor I Prokurimit ne Agjencin per Menaxhimin e Komplekseve Memoriale te Kosoves AMKMK. Sipas dokumenteve te dorezuar nga Gr OE I cili eshte shpalle perfitues se ketij aktiviteti ne si OE ankues kemi hasur qe I njeiti GR OE ka perdore dokumentat e stafit profesional, teknik dhe mbeshtetes te kompanise LONI shpk. Ku sipas CV-ve, Referencat te tyre pershkruhet se njejtin SE JANE TE PUNESUAR AKTIV tek OE LONI shpk siq jane keta persona: z.Musli Kuteshi -Inxh I Ndermtarise Konstruktiv, Emir Bunjaku Inxh Arkitektues z. Mirsim Maloku - Bachelor i Emergjencave sipas Shemsi Maloku- Teknik i ndertimtarise, Arsim Maloku – Zdrukthare, Ferat Maloku Armues, Ragip Latifi- Mjeshter, Vehbi Jetullahu-Armues. Ne si OE konsiderojme KONFLIKT INTERESI nese I njeiti stafi I lartecekur eshte pergjegjes per ekzekutimin e kontratave te cilet OE Loni shpk mund ti kete aktive me AK-se AMKMK ku drejtor I prokurimit eshte z.Mulaj. Nese vertetohet, ku kerkojme qe vertetohet se OE Loni shpk posedon kontrata aktivite me AK-se AMKMK dhe nese OE Loni shpk e angazhon te njejtin staf per ekzekutim e kontratave aktivite me AMKMK, atehere e pa arsyeshme cka te vazhdojme metutje perveq qe ta angazhoni ju si AK-se KK Prishtine - POLICINE E KRIMEVE EKONOMIKE per hetim. Si OE kontraktues kerkojme nga ana e juaj si Zyre e prokurimit qe te kerkoni ne KRPP ose ne AMKMK se OE Loni shpk Prishtine a ka kontrata aktive me AMKMK dhe nese po sa kontrata aktive I posedon dhe a eshte I njeiti staf I anagzhuar ne keto kontrata sepse sipas Referencave te ketyre te punesuar ceken kontrata qe OE Loni ka qen cdo here OE kontraktues me AMKMK ku z.Mulaj eshte drejtort I prokurimit. Pika ankimore nr 3 Sipas Informatave te kompanise tone z.Emir Bunjaku me profesion Inxhiner I Akitektures. Ku i njeiti ende vazhdon te punon ne NDERMARRJEN PUBLIKE BANESORE. Ku ndermarrja publike banesore NPB eshte ndermarrje publike e Komunes se Prishtines – Komuna e Prishtines eshte aksionar 100% e NPB, Ne si OE konsiderojme KONFLIKT INTERESI angazhimin z. Emir Bunjaku-t nga kompania Art/Eda shpk per kete aktivitet prokurimit ku Kontraktues se aktiviyitit eshte Komuna e Prishtines ku z. Bunjaku eshte I angazhuar si I punesuar Aktiv I Komunes se Prishtines, duke u bazuar se NPB eshte ndermarrje publike e Komunes Prishtines ecila I posedon 100 % aksionet e NPB. Eshte jo ligjore qe I punesuar aktiv I Komunes se Prishtines te angazhohet nga Gr OE fitues si I punesuar per aktivitetet e prokurimit/kontrate te Komunes se Prishtines. Pika ankimore 4 Dokumenti Marreveshje per qera te mjeteve dhe paisjeve I dates 04.06.2025 I lidhure ndermjet anetarit te grupit H&S Partners Group shpk dhe Gal Group shpk ne asnje nene te marreveshjen nuk jane pershkruar se cilet Paisjet/Makineri I kontraktujne Palet. Dokumenti Marreveshje per qera te mjeteve dhe paisjeve I dates 04.06.2025 I lidhure ndermjet anetarit te grupit H&S Partners Group shpk si huamarres dhe Loni shpk si huadhes ne asnje nene te marreveshjen nuk jane pershkruar se cilet Paisjet/Makineri I kontraktujne Palet. Qe si OE pretendojme se keto marreveshje nuk permbushin kushtin kontraktual ndermjet huadhenesit dhe huamarresit sepse ne cdo Marreveshje ndermjet huadhenesit dhe huamarresit duhet pershkruhet se cila Paisje mirret me qira. Si

argument OE fitues Art-Eda shpk ne dokumentin LISTA E MAKINERISE DHE MJETEVE TE PUNES, STABILIMENTEVE DHE PAISJEVE TEKNIKE, ku ne PIKEN 2 TE LISTES SE PAISJEVE ESHTË I pershkruar me Numer Tabelave KAMIONET wolkswagen 01-7523-NL, ku per ket paisje ka ofruar Librezen e paisjes tjeter KAMIONET me Numer Tabelave 01-714-PM . KJO ARGUMENTON SE MARREVESHJA E DOREZUAR NGA GR OE FIUES NUK I PLOTESON KUSHTET KONTRAKTUALE LIGJORE NDERMJET HUADHENESIT DHE HUAMARRESIT Kushtet kontraktuale I nderuar z. Shehu Nese shkon tek NOTERI per ta bere ne kontrate mbi qirane e nje lokali, Noteri nuk bejne asnje marreveshje/kontrate kontraktuale ndermjet huadhenesit dhe huamarresit PA PERCAKTUAR/ SPECIFIKUAR SE CILIN LOKAL JEPET ME QIRA. OE ENGINEERING – I Pika ankimore nr 1 PA PERGJEGJSHËM Kamioni me kran me nr tab:06- 185-CU eshte me peshe mbartese 5.22 Ton , ndersa ne shikohet sepse eshte I padukshem. ALBI COMPANY I PERGJEGJSHËM Ne piken 2.3 te kerkeses 2 ju si AK-se keni kerkuar : Nje Inxhinier I diplomuar I ndertimtarise, te jete I certifikuar APO te ofroje deshmi mbi Trajnimet te kryera nga prodhuesit per sistemet hidroizoluese kristalizuese, riparuese dhe mbrotjes min 3 vite pervoje pune pas diplomimit. Ju si AK-se ne pershkrimin e kriterit keni lene dy mundesi qe Inxhinieri i diplomuar I ndertimtarise te jete I Certifikuar APO te ofroje deshmi mbi trajnimet sepse vet pershkrimi I fjales APO nenkuptom dy mundesi. Andaj Certifikata e dorezuar nga ne si OE per inxhinierin eshte sipas standardeve per Hidroizilom e cila eshte e njejte, e barazvlefshme, ekuivalente – Ku ne keto trajnime mesohet standartet e hidroizilomit, procedura e perdorimit, karekteristikat e materialeve hidroiziluese, specifikat e materialeve hidroiziluese. Andaj pse qenka e pa vlefshme per ju si AK-se kjo certifikate nese permbushe kerkesen per sistemet hidroizoluese. Certifikata e dorezuar eshte ne pajtueshmeri me paragrafin 26.6 te nenit 26 Rregullores 001/2022 ndryshuar plotesuar me rregulloren 002/2024 pasi qe kjo qertifikate permbushe standartet te caktuara te cilesise qe bazohen ne standarde europiane ose nderkombetare. Andaj kerkesa e juaj nuk eshte ne perputhje me paragrafin 25.5 nenit 25 Rregullores 001/2022 te plotesuar ndryshuar me rregulloren nr 002/2024. Kompanite prodhuese nuk kan baze ligjore qe te ofrojne certifikate sepse nuk jane shkolle te Licencuar nga ana e Shtetit per te Certifikuar Inxhiniera apo staf tjeter. Kompanite prodhuese ofrojne vertetim per pjesemarrje mbi ndonje organizim qe prezentojne specifikimet e produkteve dhe proceduren e perdorimit te tyre gjate implementimit. Ju si AK-se gjate perpilimit te deshmise per kerkesen nr 3 keni lene mundesine sepse keni perdore fjalen OSE vetem tek deklarata unike doganore keni kerkuar kopje te noterizuar nga origjinali per deshmiten e kerkuara. KU komisioni vleresues ne pershkrimin e vleresimit te njoftim vendimit te Ak-se e ka bere ndryshimin e kriterit te cilen nuk eshte kerkuar siq peshkruhet ne eliminimin Per paisjen e kerkuar 3.3 Mjet veteshkarkues damper min 2m3 ne si OE kemi dorezuar Dudin R9630 te noterizuar me peshe 2800kg dhe Dudin R 7784 te noterizuar - ku ne pershkrim shkruan qarte - PAISJE PER LIVIZJE JASHTË RRUGES- qe nenkupton se kjo paisje me ligj nuk regjistrohet apo si eskavatori, ngarkuesi, etj qe jane paisje nderimore brenda vendpunishtes nuk kerkohet me ligj qe te regjistrohen. Per secilen paisje ne si OE kemi dorezuar Faturen e Noterizuar ose Faturen me fletepagese nga Banka qe argumenton dhe verteton vertetesin e fatures se blerjes. A jeni ju ne dijeni si AK-se qe OE ne te kaluaren sipas Ligjit kan mund me bere blerje deri 500 euro duke bere pagesen Cash, ndersa tani OE mund te blejne deri 300 Euro duke paguar ne Cash, Apo blerjet me kupon fiskal qe bene pagesat CASH”.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Ju njoftojmë se oferta juaj është refuzuar për arsyet në vijim:
kjo ofertë rezultoi e papërgjegjshme për arsyet se OE-ik me ofertën e tij nuk ka dorëzuar sipas kërkesës së DT-se dhe njoftimit për kontratë sepse komisioni gjatë shqyrtimit dhe analizimit të kësaj oferte konstaton:

1. Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (pika 2.3) Kërkohej të jetë i certifikuar nga prodhues për sistemet hidroizoluese, kristalizuese, riparuese dhe mbrojtëse, me minimum 3 vite përvojë pas diplomimit. Grupi nuk ka ofruar dëshmi të certifikimit nga një prodhues të këtyre sistemeve, por vetëm një certifikatë nga një kompani që merret me shërbime të sistemit të menaxhimit, e cila nuk është kompani prodhuese. Bazuar në këtë OE nuk plotëson kërkesën e AK-së.
2. Mjet vetëshkarkues (damper) min. 2 m³ - së paku 1 copë (pika 3.3): Kërkohej kopje e librezës së qarkullimit valide si dëshmi. OE nuk ka ofruar kopje të librezës së qarkullimit, por vetëm faturën e blerjes dhe dudin doganor. Në këtë mënyrë nuk plotëson kërkesën.
3. Mjet ngritës me kovë për vend punishte - së paku 1 copë (pika 3.4) Kërkohej kopje e faturës së blerjes së noterizuar së bashku me dëshmi pagese nga banka, kontratë shitblerje ose deklaratë doganore, 5. Hillt për demolim - së paku 2 copë (pika 3.5): Kërkohej kopje e faturës së blerjes së noterizuar së bashku me dëshmi pagese. 6. Përzierës për ngjitës - së paku 2 copë (pika 3.6): Kërkohej kopje e faturës së blerjes së noterizuar së bashku me dëshmi pagese. 7. Thithëse elektrike - së paku 2 copë (pika 3.7): Kërkohej kopje e faturës së blerjes së noterizuar së bashku me dëshmi pagese. 8. Rrafshuese gleti - së paku 2 copë (pika 3.8): Kërkohej kopje e faturës së blerjes së noterizuar së bashku me dëshmi pagese, OE për pajisjet e lartcekura nuk ka paraqitur dhe dëshmuar kërkesat sipas dëshmisë se kërkuara për pajisjet

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi nuk i konteston fare arsyet eliminuese respektivisht nuk e konteston faktin që ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Rrjedhimisht është gjetur se elimini i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e papabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 23.07.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.